

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6986  
E shtunë, 2 shtator 2023  
Çmimi 0.40 €

## Nis festa e vjeljes së rrushit



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NIS VITI I RI SHKOLLOR 2023-2024 NË KOSOVË

# MËSIMI FILLON ME MUNGESË TË LIBRAVE PËR NXËNËS



Viti i ri shkollor 2023-2024 ka filluar me vështirësi në Kosovë. Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHII), që tekstet shkollore këtë herë t'i

blejnë prindërit, pastaj ministria t'i subvencionojë ata, ka sjellë probleme në mbarrëvajtjen e fillimit të procesit mësimor. Shumica e nxënësve ditën e parë të

mësimi e kanë nisur pa tekste shkollore në mungesë të mundësive për t'i blerë. Më herët qeveritë e kaluara tekstet shkollore i kanë shpërndarë falas

**MUSMURATI: 70 EURO SUBVENCION PËR FAMILJET E PRISHTINËS PËR REGJISTRIM TË FËMIJËVE NË ÇERDHE PRIVATE**

FAQE 3



**MUNGESA E QENDRËS PËR DJEGIE MBINGARKON KIRURGINË PLASTIKE**

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SHORTI I LIGËS SË KONFERENCËS, I PAMËSHIRSHËM PËR BALLKANIN**

F. 10



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)



**INFINITY**  
Digital Agency

Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...

## AKTUALE



**BORRELLI: KURTI DHE VUÇIQI TAKOHEN MË 14 SHTATOR F. 3**

**NDIHMA E SHBA-SË PËR UKRAINËN RREZIKON TË VENITET F. 5**

**ZKA-JA: SISTEMI SHTETËROR I MANGËT NË MBROJTJEN DHE REHABILITIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE F. 7**

## EKONOMI



**NGRITEN ÇMIMET E PRODUKTEVE TË IMPORTUARA NË KOSOVË F. 8**

**POLICIA SEKUESTRON NJË SHUMË PARASH NË PEJË, DYSHOHET SE ERDHËN NGA SERBIA F. 8**

## SPORT





# ShBA-ja, 12 miliardë dollarë për tranzicionin e makinave elektrike

WASHINGTON, 1 SHTATOR - Administrata e presidentit Biden po u ofron 12 miliardë dollarë firmave të prodhimit të makinave që t'i përshtatin fabrikat e tyre për të ndërtuar automjete elektrike dhe makina të tjera të avancuara, tha sekretarja e Energjisë, Jennifer Granholm. Ndihamat do të jenë në formë grantesh dhe kredish. "Ndërsa kalojmë te makinat elektrike (EV), duam të sigurohemi që punonjësit të trajnohen në këtë fushë, që të mos mbetet pas asnjë punonjësi apo komunitet", tha Granholm, e cila ka shërbyer më parë në pozitë të guvernatores së Michiganit, qendrës së prodhimit të automobilave.

Përshtetimi i ndarjes së granteve dhe subvencioneve të tjera për financimin e konvertimit të fabrikave ekzistuese për të ndërtuar makina elektrike mund t'i zbusë kritikën e ashpër nga

prodhuesit e makinave dhe sindikatat e punonjësve kundër propozimeve të Shtëpisë së Bardhë për rregulla mjedisore që synojnë të nxisin kalimin në epokën e makinave elektrike. Sindikatat kanë paralajmëruar se një ndryshim i shpejtë mund të vërë në rrezik mijëra vende pune në shtete si Michigani, Ohajo, Illinoi dhe Indiana.

Javën e shkuar pjesëtarët e sindikatave të autoindustrialit votuan me shumicë dërrmuese në favor të autorizimit të një greve që përfshin linjat e prodhimit të tre gjigantëve amerikanë, General Motors, Ford dhe Chrysler.

Sindikatat thonë se do të hidhen në grevë nëse nuk arrihet një marrëveshje lidhur me pagat dhe planet e pensioneve përpara skadimit të kontratës aktuale katërvjeçare më 14 shtator.

Presidenti i sindikatave e vlerësoi njoftimin të enjten duke thënë se



"kjo e bën të qartë për punëdhënësit se kalimi te makinat elektrike duhet të përfshijë partneritetet e forta me sindikatat, shoqëruar me paga dhe standarde të larta sigurie për të cilat kanë luftuar dhe fituar

gjeneratat e sindikalistëve".

Presidenti Joe Biden tha në një deklaratë se "ndërtimi i një ekonomie të bazuar tek energjia e pastër mund dhe duhet të ofrojë një mundësi të favorshme për kompanitë e automobilave dhe

sindikalistët që kanë kontribuar në ekonominë amerikane për dekada". Qeveria amerikane do të ofrojë gjithashtu 3.5 miliardë dollarë financim për prodhuesit vendas të baterive, tha Granholm.

## Greqia pret të digjen mbi 150 mijë hektarë tokë deri në fund të verës

ATHINË, 1 SHTATOR - Zjarret shkatërruese në Greqi do të shkatërronjë më shumë se 150 000 hektarë tokë deri në fund të verës, vlerësoi më 31 gusht kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, i cili fajësoi krizën klimatike për katastrofën me zjarre.

Ashtu si shumë vende rreth Mesdheut, Greqia është përfshirë nga zjarret masive që nga fillimi i verës. Deri më tani është raportuar për 26 njerëz të vdekur nga zjarret pyjore të shkaktuara nga kushtet e thata, era dhe nxehtësia.

Një zjarr masiv në pyllin e Dadias, të cilin Bashkimi Evropian e ka cilësuar si zjarrin

më të madh të regjistruar ndonjëherë në bllokun evropian, po vazhdon të digjet për të 13-n ditë.

Zona e djegur nga zjarret "do të kalojë 1 miliard e 500 milionë metra katrorë (apo 150 mijë hektarë), tha Mitsotakis në parlament. "A është kriza klimatike alibi për gjithçka? Jo, nuk është alibi, por është pjesë e interpretimit", tha ai.

Rreth 600 zjarrfikës, të mbështetur nga dhjetë avionë dhe shtatë helikopterë, po luftojnë me zjarrin, i cili shpërtheu më 19 gusht në një pyll të mbrojtur nga rrjeti evropian Natura 2000 dhe një habitat për shpendët



grabitqarë.

Një zëdhënës i Komisionit Evropian tha më 29 gusht se zjarri në Dadia është "zjarri më

i madh i regjistruar ndonjëherë në BE".

Blloku evropian dërgoi së fundmi 11 avionë, një

helikopter dhe 407 zjarrfikës nga flota evropiane për ta ndihmuar Greqinë.

Ky zjarr ka djegur më shumë se 81 000 hektarë deri më sot, sipas Observatorit Evropian Copernicus, një hapësirë më e madhe sesa qyteti i Nju-Jorkut. Zjarrfikësit janë duke luftuar me zjarret në rajonet ku ato mbeten aktive, sipas autoriteteve.

Në korrik, kur Greqia u godit nga një valë e zgjatur e të nxehtëit me temperatura që arrinin 46 gradë celsius në jug të vendit, shpërthyen zjarret të shumta në pyje. Zjarret më të mëdha prekën ishujt turistikë të Rodosit dhe Korfuzit.

## Papa Françesku mbërrin në Mongoli, një nga komunitetet më të vogla dhe më të reja katolike në botë



ULAN BATOR, 1 SHTATOR - Papa Françesku ka mbërritur të premtën në Mongoli në udhëtimin e tij të parë nëpër vendin me mbizotërim budist. Vizita shihet si një shfaqje mbështetjeje për 1 400 katolikët që banojnë atje, një nga komunitetet më të vogla dhe më të reja katolike në botë si dhe një përpjekje për të mbajtur një prani midis Kinës dhe Rusisë, të cilat të dyja kanë

marrëdhënie të tensionuara me Vatikanin. "Kjo është një përpjekje e qartë e Selisë së Shenjtë për t'u kujdesur për Azinë Qendrore", ka theksuar Michel Chambon, një studiues i katolicizmit në Azi. Duke folur për nevojën për ta përjetuar Mongolinë, Papa tha së fundmi se: "Ka vetëm pak banorë, një popull i vogël, por një kulturë e madhe. Mendoj se do të na bëjë mirë të

përpiqemi ta kuptojmë këtë heshtje të gjatë e të madhe, të kuptojmë se çfarë do të thotë, por jo intelektualisht, por me shqisë".

Së fundmi Papa Françesku ka folur sërish për çështjen e homoseksualitetit dhe pozicionin e Kishës, duke shpjeguar se Kisha është e hapur për të gjithë, përfshirë homoseksualët dhe transeksualët.



# Musmurati: 70 euro subvencion për familjet e Prishtinës për regjistrim të fëmijëve në çerdhe private

“Secila familje e Prishtinës që ka fëmijë të moshës nga 9 muaj deri në 6 vjeç dhe ka të hyrat familjare nën 500 euro, do të përfitojë 70 euro për ta regjistruar fëmijën në cilëndo çerdhe private të licencuar të Prishtinës”, ka thënë të premtën, në një konferencë për medie, drejtoresha e Arsimit në komunën e Prishtinës, Besianë Musmurati

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Drejtoresha e Arsimit në komunën e Prishtinës, Besianë Musmurati, ka zbuluar se kanë hapur thirrje për subvencionim të 70 eurove për familjet e Prishtinës për regjistrim të fëmijëve në çerdhe private. “Kjo është një metodë e re dhe alternativë që ta rritim përfshirjen sa më të madhe të fëmijëve të Prishtinës në edukim të hershëm, që asnjë fëmijë të mos mbetet mbrapa. Pra, secila familje e Prishtinës që ka fëmijë të moshës nga 9 muaj deri në 6 vjeç dhe ka të

hyrat familjare nën 500 euro, do të përfitojë 70 euro për ta regjistruar fëmijën e tyre në cilëndo çerdhe private të licencuar të Prishtinës”, ka thënë Musmurati në një konferencë për medie.

Drejtoresha e Arsimit ka thënë se përfshirja në çerdhe dhe edukimi i hershëm sjellin përfitime afatgjatë në zhvillimin pozitiv të fëmijës. “Arsimimi dhe edukimi transformojnë jetët e fëmijëve dhe thyjnë ciklin e varfërisë me të cilin ballafaqohen shumë fëmijë. Gjashtë vitet e para të jetës janë vendimtare. Fëmijët mësojnë më shumë gjatë gjashtë viteve të para të jetës sesa në çdo



moment tjetër të jetës së tyre”, ka thënë ajo.

Më tutje, Musmurati ka shtuar se investimi në edukimin e fëmijërisë së hershme është një mënyrë e mirë për t'i zvogëluar boshllëqet që shpesh i vendosin fëmijët me status të ulët social dhe ekonomik në disavantazh jetësor. “Prandaj, ky është një lajm shumë i mirë për prindërit e rinj që jetojnë në Prishtinë

sepse sadopak ua lehtëson barrën financiare të edukimit të hershëm për fëmijët e tyre. Si politikë e re, ky subvencionim do t'i ndihmojë edhe nënat e reja që të hyjnë në tregun e punës sa më parë dhe ta rritin përfshirjen e grave në tregun e punës”, ka thënë ajo.

Sipas saj, me subvencionimin me nga 70 euro në muaj për familjet e Prishtinës do të rritet

përfshirja e fëmijëve në çerdhe dhe edukim të hershëm dhe pjesëmarrja e grave në tregun e punës, si dhe do të lehtësohet barra financiare për shumë familje në Prishtinë. “Ne kemi ndarë 100 000 euro për financim të fazës së parë, por varësisht nga numri i aplikimeve do ta rritim edhe buxhetin. Prandaj u bëj thirrje të gjithë prindërve të Prishtinës që të hyrat familjare i kanë nën 500 euro të aplikojnë në thirrjen e hapur për subvencionim, e cila tanimë është në uebfaqe të komunës së Prishtinës dhe në rrjetet tona sociale”, ka thënë Musmurati.

Të gjithë qytetarët mund ta bëjnë aplikimin edhe në sportelin numër pesë në objektin e komunës së Prishtinës. Kategoritë të cilat do të kenë përparësi janë nënat vetushqyese, fëmijët bonjakë, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e prindërve të shkurorëzuar, fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së si dhe fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së.

## Borrelli: Kurti dhe Vuçiqi takohen më 14 shtator



PRISHTINË, 1 SHTATOR - Takimi i radhës i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të zhvillohet më 14 shtator, ka njoftuar në një konferencë për shtyp në Spanjë përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell.

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit më 2 maj - nëntë ditë pas zgjedhjeve të

jashtëzakonshme në veri të Kosovës, të cilat janë bojkotuar nga popullata lokale serbe. Nga ajo kohë mes dy vendeve ka pasur një sërë tensionesh dhe krizash.

Më 30 gusht BE-ja përsëriti thirrjen për të dyja që të krijojnë një klimë për vazhdimin e dialogut.

Dy vendet, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, janë në bisedime për normalizimin e

marrëdhënieve qysh në vitin 2011. Ndonëse kanë arritur dhjetëra marrëveshje në fusha të ndryshme, zbatimi i shumicës prej tyre ka ngecur.

Gjatë konferencës së tij, Borrelli ka njoftuar se së bashku me presidentin spanjoll të BE-së do të mbajë një konferencë të përbashkët në nivel të ministrave të Jashtëm të Ballkanit Perëndimor për ta analizuar situatën në rajon. Ai

shtoi se kjo do të bëhet krahas takimeve të tjera që do të zhvillohen, siç është samiti i Procesit të Berlinit. “Çështja e zgjerimit ka qenë në diskutimet tona. Kemi diskutuar për Ukrainën dhe për zgjerimin drejt Ballkanit perëndimor. Do të mbetet procesi i zbatuar në meritat individuale”, ka thënë ai duke shtuar se edhe BE-ja ka nevojë të përgatitet për zgjerim. Presidenti i Këshillit Evropian,

Charles Michel, ka propozuar këtë javë që viti 2030 të caktohet si afat deri kur edhe Bashkimi Evropian, edhe vendet kandidatë, duhet të jenë të gatshme për zgjerim. Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri i ka bërë këto komente në një konferencë për shtyp pas takimit joformal të ministrave të Jashtëm të BE-së në Toledo të Spanjës.





NIS VITI I RI SHKOLLOR 2023-2024 NË KOSOVË

# Mësimi fillon me mungesë të librave për nxënës

Viti i ri shkollor 2023-2024 ka filluar me vështirësi në Kosovë. Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), që tekstet shkollore këtë herë t'i blejnë prindërit, pastaj ministria t'i subvencionojë ata, ka sjellë probleme në mbarëvajtjen e fillimit të procesit mësimor. Shumica e nxënësve ditën e parë të mësimit e kanë nisur pa tekste shkollore në mungesë të mundësive për t'i blerë. Më herët qeveritë e kaluara tekstet shkollore i kanë shpërndarë falas

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 1 SHTATOR** - Përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale të Kosovës kanë shprehur urime të premtën për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024. Presidentja Vjosa Osmani i ka uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për vitin e ri shkollor, duke theksuar se ky është një kapitull i ri që nxënësit të mësojnë diçka të re. "Me mendje të hapura për dije dhe zemra të mbushura me emocione, nxënësit tanë po e nisin këtë vit të ri shkollor, i cili është një kapitull i ri, një mundësi për të mësuar diçka të re, për ta

sfiduar veten dhe për ta zgjeruar horizontin e dijes", ka thënë Osmani.

Më tej, presidentja Osmani ka theksuar se beteja për dije nuk përfundon kurrë. "Ndërsa po nisni një vit të ri shkollor, le ta sjellim në vëmendje se arsimimi nuk ka të bëjë vetëm me libra dhe teste, por me kultivimin e ndjeshmërisë, të menduarit kritik dhe kreativitetin. Beteja për dije nuk përfundon kurrë! Urime 1 shtatori! Sukseset e shënoftëni çdo ditë të këtij viti shkollor!", ka theksuar Osmani.

Kryeministri Albin Kurti i ka uruar nxënësit, mësimdhënësit e prindërit për fillimin e vitit të ri shkollor. "Në veçanti uroj të gjithë

nxënësit që për herë të parë ulen në bankat shkollore. Për ta sot fillon një rrugëtim i ri, i cili do të përcaktojë të ardhmen e tyre dhe të shtetit të Kosovës. Për ta përmbushur obligimin tonë për të siguruar tekstet shkollore, këtë vit kemi zgjedhur një rrugë të re. Po ashtu, si asnjë vit më parë, përveç teksteve shkollore, po ndajmë edhe mjete shtesë për materiale shkollore të nevojshme për nxënësit tanë", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Ai ka thënë se arsimit dual për këtë vit shkollor po zgjerohet në gjithsej 12 profile të ndryshme, në 21 shkolla profesionale dhe 13 komuna, duke ndërtuar kështu urën ndërmjet arsimit dhe ekonomisë, diplomës së shkollës dhe vendit të punës. "Me punë e përkushtim do ta realizojmë misionin tonë për një arsim cilësor, që edukon, shkollon dhe përgatit për përmbushjen e ëndrrave, synimeve dhe potencialit të rinisë sonë", ka theksuar Kurti.

Edhe ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Arbërie

Nagavci, i ka uruar nxënësit për fillimin e ri të vitit shkollor. Nagavci përmes një video-mesazhi të publikuar në "Facebook" ka theksuar se janë duke punuar për rritjen e cilësisë në arsim. "Nxënës, mësues e prindër, urime viti i ri shkollor! Sot shkollat tona hapin dyert për t'i mirëpritur fëmijët, në ditën e parë të vitit shkollor. MASHTI, në bashkëpunim me komunat e shkollat, ka bërë të gjitha përgatitjet për të filluar vitin e ri shkollor 2023-2024. Si ministri po punojmë çdo ditë për ta përmirësuar infrastrukturën shkollore dhe ligjore. E vazhdojmë punën tonë për rritjen e cilësisë së teksteve mësimore", ka thënë ajo. Sipas saj, MASHTI-i me vendosmëri po avancojnë politikat arsimore. "Në bashkëpunim të vazhdueshëm e konstruktiv me shkollat e prindërit, dhe me angazhimin e palodhur të mësimdhënësve e stafit tjetër në shkollë", ka thënë Nagavci.

Kryetari i Partisë Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi, ka uruar vitin e ri shkollor, duke

theksuar se kjo është ditë e veçantë dhe emocionuese, posaçërisht për nxënësit që e nisin këtë rrugëtim për herë të parë. "I kuptoj shqetësimet tuaja si prindër se kjo aventurë e jashtëzakonshme për fëmijët tuaj u shoqërua me zhgënjime të mëdha si pasojë e dështimit të qeverisë për t'i siguruar librat për të gjithë nxënësit me kohë dhe në mënyrën e duhur. Por, ky dështim le të mbetet në ndërgjegjen e qeverisë para se të bëhet pengesë për ëndrrat e fëmijëve tanë. Është shumë e rëndësishme që përtej këtyre sfidave të mos i lëmë synimet tona të lëkundur. Sot është një ditë për të përqaftuar ëndrra dhe aspirata të reja. Si nxënës, shfrytëzoni këtë mundësi për t'u thelluar në lëndët dhe temat që ndezin pasionin tuaj. Si mësues, udhëzoni dhe frymëzoni nxënësit tuaj me njohuritë dhe përkushtimin tuaj, duke bërë më shumë për të ofruar mbështetje aty ku është më e nevojshme. Dhe si prindër, vazhdoni të jeni shtylla mbështetëse për fëmijët tuaj, duke rrënjësuar besimin se

## Mavraj: Ky është shtatori i tretë radhazi me defekte të rënda për sistemin arsimor

Publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka reaguar për fillimin e vitit të ri shkollor në Kosovë. Ai ka shkruar në "Facebook" se ky është shtatori i tretë radhazi me defekte të rënda për sistemin arsimor. "Po shkëlqen talenti i rrëmujës dhe demotivimit të trekëndëshit mësues-nxënës-prindër. Klubi i stanit fëmijëve nuk ua bleu librat. Synon t'ua blejë prindërit, duke ua mërzhitur jetën sa më shumë!", ka shkruar Mavraj në "Facebook".

**Postimi i Mavrajt:**

Ky është shtatori i tretë radhazi me defekte të rënda për sistemin arsimor, tash edhe me rrënimin

e traditës 15-vjeçare për çështjen e librave. Po shkëlqen talenti i rrëmujës dhe demotivimit të trekëndëshit mësues-nxënës-prindër. Klubi i stanit fëmijëve nuk ua bleu librat. Synon t'ua blejë prindërit, duke ua mërzhitur jetën sa më shumë! Nxënësve dhe mësuesve rëndë të nënçmuar ju shpreh urimet më të mira për vitin e ri shkollor, veçanërisht mësimdhënësve të kohës së okupimit. Ata nuk u dorëzuan kurrë. Të tjera borxhe u kishim!





# Ndihma e ShBA-së për Ukrainën rrezikon të venitet

WASHINGTON, 1 SHTATOR - "Nëse Shtetet e Bashkuara do të tërhiqeshin nga ndihma për Ukrainën, një gjë e tillë do t'i nxiste edhe shtetet e tjera ta bënin të njëjtën, si dhe do ta përçante aleancën e NATO-s", thotë për "Radion Evropa e Lirë" gjenerali i pensionuar i ushtrisë amerikane, Stephen Twitty. Sipas tij, presidenti rus, Vladimir Putin, është duke llogaritur pikërisht në këtë skenar. Prej se Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës, më 24 shkurt të vitit 2022, ShBA-ja ka dhënë më shumë se 60 miliardë dollarë ndihma për vendin në luftë - prej tyre, 43 miliardë dollarë ndihma ushtarake. Këtë javë sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, shpalli një tjetër paketë të ndihmës për Kievin, që përfshin municione e raketa dhe kap vlerën e 250 milionë dollarëve. Shifrat e bëjnë ShBA-në kontribuuesen më të madhe në Ukrainë sa iu përket parave të shpenzuara. Por, 18 muaj pas nisjes së pushtimit rus, disa amerikanë dyshojnë se ndihma ia vlen koston.

## Çfarë thonë republikanët që synojnë presidencën?

Javën e kaluar tetë republikanët që garojnë për nominimin e partisë së tyre për kandidat presidencial u përplasën rëndë në lidhje me këtë çështje. Mes tyre kishte nga ata që thanë se, nëse do t'i fitonin zgjedhjet presidenciale të vitit 2024, ndihmën e ShBA-së për Ukrainën do ta kushtëzonin me rritje të ndihmës nga Evropa. "Evropa duhet të ngrihet. Unë do të bëj që Evropa të ngrihet dhe ta bëjë punën e saj", tha Ron DeSantis, guvernator i Floridës. Pas ShBA-së, institucionet e Bashkimit Evropian janë donatorët më të mëdha në Ukrainë. Ato ndiqen nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Kanadaja, Polonia, Franca e kështu me radhë.

Sfiduesi i DeSantisit, Vivek Ramaswamy, shkoi edhe më larg, duke thënë se nuk do ta mbështeste rritjen e fondeve për Ukrainën. "Është katastrofë", tha biznesmeni pa përvojë në pozita publike. "Ne po mbrohemi nga një pushtim përtej kufirit të dikujt tjetër, kur ato burime ushtarake duhet t'i përdorim për ta parandaluar... pushtimin e kufirit tonë jugor, këtu në ShBA", tha Ramaswamy, duke iu referuar kufirit me Meksikën, prej nga flukse të mëdha migrantësh kanë hyrë në ShBA. Disa kandidatë të tjerë, përfshirë ish-zëvendëspresidentin Mike Pence, ish-guvernatoren e Karolinës së Jugut, Nikki Haley, dhe ish-guvernatorin e Nju-Xhërsit, Chris Christie, i kritikuan këto qëndrime, duke mbrojtur mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së për Kievin.

Kandidati Donald Trump, të cilin sondazhet e opinionit e nxjerrin në epërsi, nuk mori pjesë në debat, por në një intervistë të publikuar në platformën X, tha se Rusia nuk do ta pushtonte kurrë Ukrainën sikur ai të ishte president. Trumpi, i cili ka shërbyer si president i ShBA-së nga viti 2017 deri më 2021, nuk solli ndonjë provë për këto pretendime.

## Bie mbështetja për fonde shtesë për Ukrainën

Në bazë të një sondazhi që ka publikuar rrjeti televiziv CNN, muajin e kaluar 45 për qind e amerikanëve e mbështesin mënyrën sesi presidenti aktual, Joe Biden, i cili do të garojë për rizgjedhje, e ka trajtuar situatën në Ukrainë. Megjithatë, sipas të njëjtit sondazh, shumica e amerikanëve, përkatësisht 55 %, nuk pajtohen që Kongresi të autorizojë fonde shtesë për Ukrainën. Ndërsa 45 për qind thonë se Kongresi duhet të autorizojë fonde të tilla.

Ky sondazh është kryer nga data



1 deri më 31 korrik, me një mostër prej 1 279 të rriturish. Për krahasim, një sondazh i kryer në ditët e para të pushtimit rus, në fund të shkurtit 2022, ka zbuluar se 62 % e amerikanëve mendonin se ShBA-ja duhej të kishte bërë më shumë.

## Pa ShBA-në, "Ukraina nuk do të jetë në gjendje të vazhdojë..."

Gjenerali i pensionuar amerikan Stephen Twitty thotë se është vështirë të përcaktohet nëse ndihma amerikane për Ukrainën do të vazhdojë me të njëjtin intensitet marrë parasysh pasigurinë e zgjedhjeve në ShBA. "Shpresoj që ShBA-ja dhe aleatët tanë të NATO-s do të vazhdojnë ta mbështesin Ukrainën. Është e rëndësishme të shohim një pamje më të gjerë sa i përket kërcënimit të paqes dhe sigurisë në kontinentin evropian", thotë Twitty.

Ben Hodges, ish-komandant i ushtrisë amerikane në Evropë, thotë se Bideni duhet të përpiqet më shumë për t'iu shpjeguar qytetarëve të tij se përse "suksesi në Ukrainë është në interes të Amerikës dhe aleatëve të saj".

"Përndryshe, mbështetja e fortë dy partiake [për Ukrainën] mund të fillojë të zbehet vitin e ardhshëm", thotë ai. "Amerikanët do të fokusohen në zgjedhje, ndërsa kundërshtarët politikë të presidentit mund të gjejnë mundësi për t'i kritikuar politikën e tij".

Hodges thotë se Kremlin shpreson në këtë: dobësimin ose pakësimin e mbështetjes së ShBA-së dhe të Perëndimit për Ukrainën.

Zyrtarët rusë vazhdimisht e kanë kritikuar ndihmën ushtarake të Perëndimit, duke thënë se ajo e bën atë pjesëmarrës në konfliktin në Ukrainë.

Mark Cancian, kolonel i pensionuar i marinës amerikane, thotë se "pa pjesëmarrjen e ShBA-së mbështetja globale për Ukrainën do të fundosej. E pa ndihmën e jashtme Ukraina nuk do të ishte në gjendje ta vazhdonte luftën". Sipas tij, tërheqja e mundshme e ndihmës ka gjasa të shoqërohet edhe me kërkesën për zgjidhje të negociuar të konfliktit. "Kjo nënkupton një armëpushim, i cili do t'i jepte Rusisë fitore të pjesshme", thotë Cancian.

Aleatët perëndimorë vazhdimisht zotohen se do ta

ndihmojnë Ukrainën "për aq kohë sa duhet", por shpesh nuk specifikojnë se sa duhet për të bërë dhe çfarë?!

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se "për aq kohë sa duhet", nënkupton mbështetje për qëllimet e vendosura nga presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, dhe populli ukrainas, e ato përfshijnë: rikthimin e territoreve të pushtuara nga Rusia - mes tyre edhe Krimenë - dhe dëbimin e forcave ruse nga toka e Ukrainës.

Për gjeneralin Hodges fraza "për aq kohë sa duhet" është "boshe". Sipas tij, atë e përdorin shumë udhëheqës për ta shmangur atë që duhet thënë, se "ne duam që Ukraina të fitojë". "Ne nuk mund ta dimë se çfarë do të ndodhte nëse Putini do të mbizotëronte në Ukrainë, por barbaria që ai ka përdorur tashmë është një tregues i vlefshëm", ka shkruar "Washington Post" në një opinion të vetin, të publikuar në korrik. "...Perëndimi duhet t'i sigurojë armët që i duhen Ukrainës për të mbijetuar... Është detyrim i botës së qytetëruar që të ndalojë një tjetër tmer", ka shkruar gazeta amerikane.

asnjë pengesë nuk është e pakapërcyeshme", ka thënë Krasniqi.

Ai ka thënë se le të jetë ky një vit rritjeje, edukimi, qëndrueshmërie dhe vendosmërie. "Le ta përballojmë çdo ditë me optimizëm, duke e ditur se kemi fuqinë për të krijuar ndryshime pozitive në jetën tonë dhe brenda komuniteteve tona. Me përpjekjet kolektive të nxënësve, mësuesve dhe prindërve, mund të kapërcehen vështirësitë me të cilat sot po ballafaqohemi. Së bashku ne mund ta kthejmë edhe këtë vit në një vit triumfi dhe arritjeje", ka thënë Krasniqi.

Në ditën e parë të vitit të ri shkollor, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar Shkollën Filllore "7 Marsi" në komunën e Suharekës. "Bashkë me kryetarin dhe deputeten

Albana Bytyqi vizitua shkollën më të vjetër në Suharekë, Shkollën Filllore "7 Marsi", me ç'rast takuam personelin dhe nxënësit. Sot më shumë se çdoherë u emocionova teksa pashë nxënësit në hapat e tyre të parë në një botë me plot mundësi. Nxënësve u thashë se jemi bashkë me ta, mësimdhënësit dhe prindërit, në synimin tonë drejt rritjes së cilësisë së arsimit dhe ndërtimit të një të ardhme më të ndritshme për vendin. Urime nxënës, mësimdhënës e prindër të dashur!", ka thënë Haradinaj.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka adresuar kritika për Ministrinë e Arsimit dhe qeverinë, ndërsa i ka uruar nxënësit dhe punëtorët e arsimit me rastin e vitit të ri shkollor. "Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, duke ju uruar juve



dhe gjithë nxënësve për vitin e ri shkollor, ju falënderoj që kësaj radhe nuk kishit kërkesa për veprime sindikale dhe kjo na jepte shpresë se ky vit shkollor do të ketë fillim dhe rrjedhë të mbarë, por MASHTI u kujdes që kjo të mos ndodhë duke sjell

vendim të gabuar për tekstet shkollore, vendim ky që ka krijuar shqetësime e stres te punëtorët arsimorë në mësimin shqip, por dhe te kolegët tanë në mësimin në gjuhën boshnjake e turke", theksohet në njoftimin e SBASHK-ut.

Ky institucion ka kërkuar angazhim maksimal të mësimdhënësve që pajisja me tekste shkollore të bëhet në mënyrën më të mirë të mundur, e sidomos për nxënësit që vijnë nga familje me gjendje më të rënduar ekonomike.




## Rininis punimet në Shtëpinë e Kulturës "Ukë Bytyçi" në Suharekë

**SUHAREKË, 1 SHTATOR** - Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku dhe kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, kanë vizituar shtëpinë e kulturës "Ukë Bytyçi" në Suharekë, në të cilën, pas disa viteve ndërprerje, kanë rinisur

punët. "Me investimin e MKRS-së në vlerë prej 2.7 milionë euro, projekti parashihet hapësira të reja të projektuara për të shërbyer si një qendër vitale dhe platformë e përshtatshme për artistët dhe artdashësit e

rajonit, për të ndarë dhe zhvilluar interesat e tyre në fushën e kulturës. Përtej hapësirës fizike, qendra do të inkurajojë bashkëpunimin, kreativitetin dhe ndërveprimin ndërmjet komunitetit", ka thënë ministri Çeku.



## Komuna e Gjilanit përmbyll ciklin e dëgjimeve për planifikim të buxhetit 2024-2026

**GJILAN, 1 SHTATOR** - Komuna e Gjilanit ka përmblytur ciklin e dëgjimeve buxhetore për planifikim të buxhetit 2024-2026. Komuna ka realizuar njëmbëdhjetë dëgjime buxhetore për planifikimin e buxhetit 2024-2026, me gratë, rininë, fermerët, profesionistë të arsimit, të shëndetësisë, profesionistë të kulturës, sportit e me personat me nevoja të veçanta, komunitetet joshumicë, me këshillat lokale të fshatrave, me lagjet e qytetit Dardania 1, Dardania 2, Dheu i Bardhë, Reshat Ymeri, Qendra, Rruga e Prishtinës, Arbëria, Zabeli i Sahitagës, Iliria, Lagja 8 dhe Hamdi Kurteshi.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me u.d. drejtorin për Buxhet dhe Financa, Ilmi Limoni, kanë paraqitur kufijtë buxhetorë për tri vitet e ardhshme, ndërkohë që kanë marrë pjesë dhe kanë adresuar qëndrimet para të pranishmëve edhe drejtorët komunalë, Kushtrim Zeqiri, Alban Demiri, Doruntina Hasani e Ali Arifi. "Për vitin 2023 buxheti ishte tre milionë euro më i lartë, ndërsa në vitin 2024 do të jetë rreth 37 milionë euro, në vitin 2025 mendojmë se do të jetë 39 milionë euro, derisa në vitin 2026 do të jetë 41 milionë euro. Po ashtu, projektbuxheti përbëhet edhe nga grantet qeveritare,



ndërsa në vitin 2023 kategoria paga dhe mëditje është struktura me më së shumti shpenzime si

dhe kategoritë e tjera me radhë. Po ashtu, në planifikim janë edhe 1.5 milion për pagesën e

borxheve të komunës", ka theksuar kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, duke shtuar se këtë vit kanë shtuar edhe disa kategori të tjera që do ta marrin kujdesin e komunës së Gjilanit. "Pra kemi kategori të veçanta. Kemi paraparë grante në të gjitha kategoritë dhe të gjitha kanë një rritje më të madhe të buxhetit krahasuar me atë që e kanë pasur deri më tash", është shprehur kreu i Gjilanit.

Kryetari i Gjilanit dhe bashkëpunëtorët u janë përgjigjur të gjitha kërkesave të qytetarëve, të cilat, sipas mundësisë të komunës, do të përfshihen në planifikim të buxhetit.

## Dogana e Kosovës, aksion në Prishtinë, cak barnatoret

**PRISHTINË 1 SHTATOR** - Njësitë e Doganës së Kosovës kanë ushtruar kontrolle në pesë lokacione të ndara (barnatore) në Prishtinë me qëllim të verifikimit të mallrave të mundshme të kontrabanduara. Bazuar në informatat e marra nga rrugët operative, njësitë e doganës kanë koordinuar një aksion në pesë lokacione. Gjatë kontrollit janë identifikuar tri lokacione, në të cilat janë zbuluar mallra pa

banderola, të fshehura në hapësira të ndryshme. Mallrat e kontrabanduara janë konfiskuar menjëherë dhe proceset ligjore kundër personave të përfshirë në këtë veprimtari të paligjshme kanë filluar. Malli i gjetur përbëhet prej më shumë se 350 llojeve të ndryshme të ilaçeve. Procedurat ligjore do të vazhdojnë për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht personat e

përfshirë në këtë veprimtari të paligjshme të kontrabandës së medikamenteve. Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka aplikacionin e-Dogana për pajisjet e mençura android dhe ios, i cili mundëson lajmërim të parregullsisë dhe sjelljeve joprofesionale me komunikim të sigurt dhe, gjithashtu, ofron shërbime të tjera me qëllim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe komunitetit të prodhuesve dhe tregtisë në përgjithësi.



## Totaj me bashkëpunëtorë bënë homazhe për nder të 25-vjetorit të Epopesë së Vrrinit



**PRIZREN, 1 SHTATOR** - Për nder të 25-vjetorit të Epopesë së Vrrinit, të premtën kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me nënkryetarin Kujtim Gashi, kryesuesen e Kuvendit Komunal, Antigona Berisha-Bytyqi, zyrtarë të ekzekutivit dhe përfaqësues të

shoqatave të dala nga lufta, kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve në Landovicë si dhe te shtatorët e heronjve të kombit Selajdin Berisha e Xhevat Berisha. Gjatë Epopesë së lavdishme të Vrrinit nga 1 deri 5 shtator 1998, në përballje me

armikun, kanë rënë në altarin e lirisë 28 pjesëtarë të UÇK-së. "Me mirënjohje e përlulje sot kujtojmë veprën e dëshmorëve për lirinë që e gëzojmë në Kosovën e pavarur. Lavdi dëshmorëve, martirëve dhe heronjve të gjallë!", është shprehur kryetari Totaj.

## Latifi pret në takim kryetarin e Bashkisë së Beratit

**RAHOVEC, 1 SHTATOR** - Me rastin e Festës së Vjeljes së Rrushit, të premtën kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka prituri në takim

kryetarin e Bashkisë së Beratit, Ervin Demo, dhe delegacionin e tij. "E falënderoi për vizitën dhe shprehi gatishmërinë për

bashkëpunim dhe për mundësinë e binjakëzimit në mes të dy qyteteve, Rahovecit dhe Beratit. Bashkë me z. Demo, në 'Hardh Fest' po

qëndrojnë edhe pesë verëtarë nga Republika e Shqipërisë", është bërë me dije në njoftimin e komunës së Rahovecit.





# Mungesa e qendrës për djegie mbingarkon Kirurgjinë Plastike

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Në dhomat e Klinikës së Kirurgjisë Plastike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) janë të shtrirë disa pacientë me nivele të ndryshme të djegieve. Për më shumë se një muaj, aty gjendet edhe S. I., i djegur pothuajse në të gjitha pjesët e trupit, e më shumë në fytyrë dhe kokë. "Jam djegur nga një gjenerator, por kam shpëtuar këtë herë", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Duke folur me vështirësi, si pasojë e djegieve edhe në buzë, S. I. thotë se shërimi po i shkon ngadalë për shkak të kushteve, siç i përshkruan ai, jo të mira në klinikë.

Me trupin mbi 50 për qind të djegur, në një shtrat tjetër është i shtrirë Agimi, 34 vjeç.

Ka më shumë se dy javë që nuk ka lëvizur fare, përveç në rastet kur i është dashur të futet në sallë të operacionit për intervenime të ndryshme. "Një shok imi ma ka dhuruar lëkurën për shumë pjesë të trup, për duar, për këmbë e disa pjesë të tjera", rrëfen me vështirësi Agimi, i djegur nga shpërthimi i një bombole gazi.

Në Kosovë nuk ka ndonjë qendër të veçantë apo të specializuar për djegie. Rastet e tilla trajtohen në Klinikën e Kirurgjisë Plastike Rekonstruktive dhe Estetike të QKUK-së, por shpesh edhe jashtë vendit.

Edhe pse është e thirrur për të

trajtuar raste të tumoreve të lëkurës dhe indeve të buta, patologji të shuplakave e të ngjashme, Klinika e Kirurgjisë Plastike trajton më së shumti raste të djegieve dhe pasoja të tyre, thonë mjekët në këtë institucion. Sipas tyre, aty pranohen së paku 2-3 raste në muaj me djegie mbi 50 për qind. Violeta Zatriqi, drejtoreshë e Kirurgjisë Plastike, thotë se një qendër e specializuar për djegie është bërë domosdoshmëri. Ajo thotë se rastet e rënda referohen jashtë vendit dhe se "kostoja për trajtimin e tyre është e madhe - mbi 100 mijë euro". "Do të thotë, është kosto që i kushton buxhetit të shtetit, por edhe buxhetit të pacientit", thotë Zatriqi për "Radion Evropa e Lirë".

Në klinikën që udhëheq ajo punojnë 13 kirurgë plastikë të cilët merren edhe me raste të djegieve.

Për shkak të përqendrimit të tyre te pacientët e djegur, Zatriqi thotë se ndodh shpesh që rastet e tjera, më pak urgjente, të trajtohen me vonesë. "Qe disa javë nuk mund të kryhet asnjë operacion tjetër, sepse duhet t'u japim prioritet djegieve", thotë ajo.

Qendër të djegieve nuk kanë as disa shtete fqinje të Kosovës, si Shqipëria apo Maqedonia e Veriut. Sipas përlogaritjeve të Zatriqit, ndërtimi i një të tilla në Kosovë do të kushtonte 6 deri në 7 milionë euro dhe do të



shërbente edhe për pacientë të vendeve afër.

## Ka plane për qendrën e djegieve

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, i cili ka nën menaxhim QKUK-në dhe spitalet rajonale, thonë se planet për një qendër për djegie ekzistojnë, por nuk japin asnjë detaj për kohën se kur do të mund të ndërtohet. "Në planin e menaxhimit të ShSKUK-së, në koordinim të plotë me Ministrinë e Shëndetësisë, drejtuesit e klinikës dhe profesionistët e fushës

përkatëse, parashihet që të ndërtohet dhe funksionalizohet një qendër e tillë", thuhet në një deklaratë me shkrim të ShSKUK-së dërguar "Radios Evropa e Lirë".

Nga 23 gushti REL-i kontaktoi edhe Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me këtë çështje, por nuk mori përgjigje.

Në Fondin për Sigurime Shëndetësore, që funksionon nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Kosovës, thonë se gjatë periudhës 2019-2023 njëmbëdhjetë persona me plagë nga djegiet kanë aplikuar për mbështetje financiare për t'u trajtuar jashtë vendit. Vetëm dy prej tyre janë financuar. "Për

këto dy raste, Fondi ka ndarë 60 mijë euro për trajtimin e nevojshëm shëndetësor", thuhet shkurtimisht në një deklaratë dhënë REL-it.

Në Kosovë, një nga incidentet më të rënda, me pasojë dhjetëra persona të djegur, ka ndodhur në vitin 2021, kur në një qendër tregtare në Ferizaj kanë shpërthyer disa bombola gazi.

Dy të lënduar nuk u kanë mbijetuar plagëve, ndërsa disa janë dërguar për trajtim jashtë Kosovës.

Sipas mjekëve në Kirurgjinë Plastike, rastet më të shpeshta të djegieve ndodhin nga aksidentet, qoftë në punë, apo në kushte shtëpie.

# ZKA-ja: Sistemi shtetëror i mangët në mbrojtjen dhe rehabilitimin e rasteve të dhunës në familje

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje" për periudhën 2020-2022. Pavarësisht se institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, auditimi konstatoi se nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave.

Sistemi shtetëror ka mangësi në angazhimin e hetuesve primarë, përfshirjen e mbrojtësve të viktimave, shqyrtimin e rasteve me kohë nga organet e drejtësisë, si dhe në regjistrimin e rasteve të raportuara. Po ashtu, viktimat nuk kanë përkrahje sociale, në veçanti mungon përkrahja e tyre në aspektin ekonomik, si dhe mungojnë programet për trajtimin e kryerësve të veprave. Procesi i auditimit identifikoi



mangësi edhe në angazhimin adekuat të burimeve njerëzore, në procedurat e monitorimit dhe në mbështetjen e viktimave gjatë rehabilitimit. Gjatë intervenimit dhe ofrimit të shërbimeve

emergjente, policia reagon në kohë optimale, porse ka dobësi në angazhim të hetuesve policorë, mungesë të procedurave për monitorimin e urdhrave mbrojtës, mospërcjellje

të informatës te mbrojtësit e viktimave si dhe dobësi në regjistrimin e rasteve.

Rezultatet e auditimit tregojnë se gjykatat me vonesë i trajtojnë rastet e dhunës në familje.

Gjykatat themelore ende ballafaqohen me bartje të lëndëve të pazgjdhura nga vitet paraprake, ku disa prej tyre janë që nga viti 2016.

Procesi i trajtimit në procedurë penale te rastet e dhunës në familje merr kohë më shumë se një vit. Po ashtu, vërehet mungesa e angazhimit institucional në regjistrimin e të dhënave në Data Bazën Nacionale për rastet e dhunës në familje.

Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme Vlora Spanca ka vlerësuar se është e domosdoshme rritja e angazhimit institucional për t'i trajtuar rastet e dhunës në familje dhe shpërndarja adekuate e burimeve.

Spanca ka thënë se zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse për rehabilitimin e viktimave, duke përfshirë mbështetjen psikologjike dhe kompensimet materiale, është me rëndësi jetike.

Me përpjekje të vazhdueshme dhe angazhime për ndryshim, institucionet përgjegjëse mund të krijojnë mjedis të atillë ku viktimat e dhunës në familje mbrohen, rehabilitohen dhe fuqizohen, duke kontribuar kështu në çrënjosjen e dhunës në familje dhe në shoqëri.

Me qëllim të përmirësimit të sistemit shtetëror për mbrojtjen dhe rehabilitimin e rasteve të dhunës në familje, ZKA dha gjithsej 19 rekomandime.

Ndër këto, tri për Policinë e Kosovës, tri për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, katër për Qendrat për Punë Sociale, dy për Prokurorinë Themelore, dy për Gjykatat Themelore si dhe pesë për Ministrinë e Drejtësisë.



## Nis festa e vjeljes së rrushit, Osmani: Me këtë traditë po mbahet gjallë ekonomia

**RAHOVEC, 1 SHTATOR** - Me sloganin "Prek n'rrush, shijo n'ven" ka nisur të premtën edicioni i 22-të i festës së vjeljes së rrushit "Hardh Fest" në Rahovec.

Edicion ky që do të zgjasë deri më 3 shtator.

Në ceremoninë hapëse të "Hardh Fest", presidentja Vjosa Osmani u shpreh e lumtur që kjo festë tashmë është bërë traditë.

Osmani ka falënderuar vreshtarët rahovecianë që me këtë traditë po arrijnë ta mbajnë gjallë ekonomikisht Kosovën. "Është kënaqësi se sot jemi në kryeqytetin e bujqësisë në Rahovec. Sot

është një moment i veçantë, jam optimiste se do të kemi një sezon të begatë të rrushit. Vreshtarët e Rahovecit po mbajnë gjallë një traditë të vjetër, ju po e vazhdoni këtë traditë të lashtë, po e gjallëroni ekonomikisht Rahovecin e gjithë Kosovën. Kjo ditë është festë e lidhjes sonë me tokën dhe njëritjetrin. Kjo festë sjell gëzim në shtëpitë tuaja e për të gjithë, sepse rrushi zakonisht ndahet me të tjerët. Ndërsa shijojmë shijen e rrushit e të verës, le të reflektojmë edhe për punën e vreshtarëve", tha Osmani.

I pari i Rahovecit, Smajl Latifi,

derisa ka falënderuar bujqit për punën, tha se këtë vit komuna ka mbështetur me shumë "Hardh Fest"-in. "Po e hapim festivalin me organizimin më të mirë në historikun e tij. 'Hardh Fest' është i të gjithëve për më shumë i bujqve. 'Hardh Festi' e ka vendosur Rahovecin në hartën e ngjarjeve kulturore e historike të Kosovës, ndërsa Kosovën e ka vendosur në hartën e botës. Festival ky që tashmë ka kaluar kufijtë tonë kombëtarë. Jam shumë i gëzuar që sivjet kemi gjetur mundësinë ta mbështetim 'Hardh Fest'-in më shumë se viteve të kaluara", tha Latifi.



Me këtë rast, Latifi ndau gjashtë çmime për vreshtarët më të mirë.

Në këtë ceremoni morën pjesë ministra të kabinetit

Kurti, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kryetarë të Bashkive të Shqipërisë dhe disa kryetarë nga komuna të tjera të Kosovës.

## Ngriten çmimet e produkteve të importuara në Kosovë

**PRISHTINË, 1 SHTATOR** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2023. Sipas këtyre të dhënave, çmimet e importit janë më të larta në tremujorin e dytë të 2023-s sesa në tremujorin e dytë të vitit 2022. Në njoftimin për medie thuhet se indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë u ngrit për 1,1 % në TM2 2023 krahasuar me TM1 2023. Ndërkaq, krahasuar TM2 2023 me TM2 2022 çmimet e importit u ngritën në mesatare prej 5,0 %.

**Tremujori i dytë  
2023 - tremujori i parë  
2023 1,1 %**

Çmimet e importit në Kosovë patën një ngritje në një mesatare prej 1,1 % në TM2 2023 krahasuar me TM1 2023. Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore, muzikore dhe mekanizmat e orës (14,5 %); tekstili dhe artikujt e tekstilit (11,9 %); lëkura dhe artikujt e saj (11,5 %) etj. Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-12,3 %); këpucët (-3,4 %); plastika, kauçuku dhe



artikujt e tyre (-2,2 %); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-2,1 %) etj.

**Tremujori i dytë  
2023 - tremujori i dytë  
2022 5,0 %**

Çmimet e importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 5,0 % në TM2 2023 krahasuar me TM2 2022. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet bimore (27,6 %); letra dhe artikujt e saj (19,4 %); tekstili dhe artikujt e tij (17,9 %);

instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore, muzikore dhe mekanizmat e orës (13,5 %); mjetet e transportit (12,8 %); lëkura dhe artikujt e saj (10,2 %) etj. Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-11,5 %); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-5,9 %); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-5,2 %) dhe produktet minerale (-3,2 %). Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te:

vajrat ushqyese (-12,3 %); këpucët (-3,4 %); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-2,2 %); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-2,1 %) etj.

**Tremujori i dytë  
2023 - tremujori i dytë  
2022 5,0 %**

Çmimet e importit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 5,0 % në TM2 2023, krahasuar me TM2 2022. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet

bimore (27,6 %); letra dhe artikujt e saj (19,4 %); tekstili dhe artikujt e tij (17,9 %); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore, muzikore dhe mekanizmat e orës (13,5 %); mjetet e transportit (12,8 %); lëkura dhe artikujt e saj (10,2 %) etj. Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-11,5 %); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-5,9 %); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-5,2 %) dhe produktet minerale (-3,2 %).

## Policia sekuestron një shumë parash në Pejë, dyshohet se erdhën nga Serbia

**PRISHTINË, 1 SHTATOR** - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka sekuestruar një shumë parash në Pejë të cilat dyshohen se kanë ardhur nga Serbia. Lidhur me rastin, policia ka intervistuar disa persona.

"Lidhur me rastin, prokurori i rastit ka pranuar një informatë se nga disa persona është sjellë një shumë e parave nga Kopaoniku i Serbisë dhe janë duke u dërguar në Pejë. Gjatë kontrollit janë gjetur dhe

sekuestruar një shumë parash", ka njoftuar policia. Policia shton se personat janë intervistuar dhe me vendim të prokurorit janë liruar, kurse rasti është në procedurë hetimore.





# Intervista e Thaçit - përjetim apo presion? (1)



**Shkruan: Agron HOTI**

Njoftimi i paracaditshëm i drejtuesit të mediumit online "Nacionale", Berat Buzhala, për një intervistë me ish-kryetarin e Kosovës, Hashim Thaçi, të cilën ai e pati cilësuar si "eksplozive dhe ekskluzive", do të përbëjë padyshim njërin ndër lajmet kryesore në Kosovë dhe jo vetëm. Nëse intervista lejohet të publikohet, ajo do të jetë personale ose politike. Nëse është vetëm përjetim personal, do të jetë vetëm "ekskluzive", ngase është e para që pas shkuarjes së Thaçit në Hagë, ndërsa nëse është politike, atëherë do të jetë dhe "eksplozive", sepse deri më tani askush nga të akuzuarit e Kosovës nga Specialja apo Tribunali i Hagës s'është lejuar të japë deklarata politike e aq më pak gjatë procesit të gjyqimit. Nëse intervista do të jetë "eksplozive", atëherë i ajo përgjigjet drejtpërdrejtë ngutisë amerikane për ta rritur presionin ndaj Qeverisë së Kosovës për ta nxjerrë Kosovën nga kurtha ku vendi tanimë edhe zyrtarisht është futur nën masa ndëshkimore perëndimore. Intervista, pra, vjen në një kohë kur SHBA është duke këmbëngulur në zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit mes Kosovës dhe Serbisë, për ta larguar kështu sa më shpejtë Rusinë nga Ballkani Perëndimor dhe për ta kthyer këtë të fundit përfundimisht dhe tërësisht kah Perëndimi. Jo-rastësisht SHBA ka ri-dinamizuar së fundmi dhe aleancat në Evropë duke u përqendruar kryesisht te Britania e Madhe, Gjermania e ri-armatosur dhe Evropa Lindore me Poloninë në epiqendër të interesave amerikane, duke e përfshirë në këtë mes dhe Evropën Juglindore, Turqinë dhe Kaukazin Jugor për ta rrethuar kështu Pellgun e Detin të Zi në disfavor të Rusisë. Se çfarë mesazhesh do të mund të përçonte një intervistë politike e Thaçit në rrafshin ndërkombëtar dhe kombëtar do të mundohem ta shtjelloj si më poshtë:

**Zhvillimet ndërkombëtare mes SHBA-së, Evropës e Azisë**

Zhvillimet politike ndërkombëtare

rallë ndodhin të shkëputura nga njëra tjetra. Një krizë, avari e madhe (p.sh. ngujimi i paracavitshëm i anijes transportuese në Kanalin e Suezit), ose një tension, luftë, projektion apo garë zhvillimore mes dy apo më shumë shteteve të fuqishme nuk lë pa prekur pothuajse tërë globin. Dhe këtë garë të pandalshme ndërkombëtare superfuqitë dhe shtetet e fuqishme, edhe kur janë në raporte rivaliteti mes tyre, e që në fakt gjithmonë janë, më parë preferojnë shmangien sesa përbaljen e drejtpërdrejtë mes tyre dhe këtë e bëjnë pikërisht pse i dinë shumë mirë pasojat e përbaljes.

Më lehtë është për Iranin ta pengojë së brendshmi konsolidimin e demokracisë në Irak, Siri, Jemen, Liban, sepse vetëm kështu Irani sfidon Perëndimin, më konkretisht SHBA-në dhe kundërbalancën Arabinë Saudite, Egjiptin, Turqinë, Izraelin e SHBA-në, etj, sesa të përballet drejtpërdrejtë ushtarakisht me këto shtete, ose shumë më lehtë është për SHBA ta mbështesë rezistencën e Ukrainës kundër Rusisë sesa të futet drejtpërdrejtë në luftë kundër Rusisë, ose më lehtë është për SHBA ta bëjë tërë Evropën për vete për ta sfiduar Rusinë ose ta bëjë për vete Azinë Lindore e Juglindore për ta sfiduar Kinën sesa të përballet drejtpërdrejtë me Kinën; edhe për Rusinë është shumë më lehtë të përballet ushtarakisht me Ukrainën, Gjeorgjinë, Moldavinë, ta nxisë Serbinë në Veri të Kosovës e Bosnje e Hercegovinë, ta korruptojë e përçajë BE-në sesa t'i hapë front drejtpërdrejtë SHBA-së.

Shumë më lehtë për Francën është ta mbështesë Greqinë ndaj Turqisë në Mesdhe dhe pse jo së fundmi edhe ndaj Shqipërisë së faktorizuar nga SHBA, pastaj ta mbështesë Serbinë për të mos e zgjidhur problemin me Kosovë së paku jo siç po kërkon SHBA, sepse vetëm një Ballkan i trazuar si thikë mes BE-së dhe Turqisë pengon çfarëdo aleance të mëtejme ekonomike mes Gjermanisë dhe Turqisë, pastaj rritja e bashkëpunimit ekonomik mes Francës me Arabi Saudite, Liban e Izrael bëhet për ta kundërbalancuar Turqinë dhe SHBA-në, pastaj rritja e bashkëpunimit të Francës me Rusi në Arktik e aq më tepër rikthimi i Francës kah Mesdheu tregon për rirreshtimet më të fundit të shtetit francez përbalë rirreshtimeve të SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë.

Edhe një hapësirë shqiptare e fuqishme me Tiranën tanimë në epiqendër të shqiptarëve bashkë

me Italinë pengojnë çfarëdo depërtimi rus në Adriatik si interes jetik i SHBA-së dhe tërë Perëndimit; një Turqi e fortë në Mesdhe e pengon çfarëdo dalje ruse në ujëra të Mesdheut që është interes jetik i SHBA-së dhe Britanisë së Madhe para se gjithash. Një ndalje e refugjatëve nga Turqia që do të synonin Evropën, parandalon rritjen e ekstremistëve djathtë në Gjermani. Ose më lehtë për Turqinë për ta sfiduar Perëndimin është xhamijezimi i përditshmërisë në Bosnje, Shqipëri, Maqedoni të Veriut e Kosovë, sesa të përballet drejtpërdrejtë me Perëndimin.

Superfuqitë dhe shtetet e fuqishme përdorin të gjithë mekanizmat politikë, ekonomikë, fetarë dhe pse jo edhe ushtarakë për aq sa e mundshme për të zgjeruar aleancat e tyre, sepse një përkrahës më shumë, në praktikë do të thotë një ushtar më shumë në ditë të liga. Kjo mënyrë aleancizimi nuk ka ndryshuar që prej se ekziston njerëzimi dhe nuk do të ndryshojë as në të ardhmen. Rritja e kontrollit të Turqisë nëpër xhamia të Ballkanit Perëndimor, automatikisht do të thotë më shumë mbështetës apo më konkretisht ushtarë për kauzën turke në ditë të liga. Festimet në Kosovë për fitoren elektorale të Erdoganit në zgjedhjet e fundit presidenciale në Turqi e konfirmojnë më së miri investimin turk në Kosovë. Dhe pak a shumë kështu vazhdon aleancizimi në glob.

Kështu Kina në pamundësi që të përballet sot me flotën detare amerikane në Detin e Kinës Jugore ka zgjedhur të investojë edhe më tej në flotën e saj me shpresën e një përbaljeje të mëvonshme me SHBA, ose p.sh. derisa SHBA ishte e nxënë me luftën e saj ndaj terrorizmit 2001-2021 në Lindje të Mesme dhe Azi Qendrore, Kina po mendohej ta rriste prezencën e saj ushtarake në Indo-pacifik dhe të depërtonte sa më thellë ekonomikisht në Evropë, Afrikë dhe Amerikë Jugore. Të njëjtën gjë po bënte Rusia, duke e futur Evropën gjithnjë e më shumë nën varësinë energjetike të saj si dhe duke iu bashkuar Kinës në BRICS (Brazil, Rusi, Indi, Kinë dhe Afrikë Jugore), a tëra kjo për t'i konkurruar Perëndimit, e para se gjithash SHBA-së.

Nuk ishte kurrfarë rastësie që politikanë të caktuar evropianë po flirtonin hapur me Kinën, Rusinë, Iranin, Vendet Arabe e Turqinë duke harruar kështu që SHBA vazhdon edhe sot t'i ruajë shpinën Evropës pikërisht nga shtetet e lartpërmendura, me theks të veçantë nga Rusia e Kina. Mos-koordinimi apo thënë më



mirë rezistimi i evropianëve ndaj SHBA-së për t'i rritur shpenzimet ushtarake të NATO-s nga secili shtet anëtar përbalë një rrezikimi të Perëndimit nga Kina e Rusia me aleatë të tyre, po e trimëronte gjithnjë e më shumë Rusinë dhe Kinën, të cilat po fitonin terren para se gjithash në Evropën e dobët ushtarakisht dhe të përçarë politikisht.

Fatkeqësisht, politikanë të shumtë evropianë kishin rrëshqitur nën korupsionin e llahtarshëm të nxitur nga Kina e Rusia dhe as që po iu bënte se ç'po paralajmëronte SHBA për rrezikun rus e kinez sidomos që nga koha e Presidentit Obama, Trump që kulmoi me Biden. Ishte për keqardhje kur BE po kritikonte vendet e Ballkanit Perëndimor për korupsion, gjersa elita e saj politike ishte zhytur deri në fyt në korupsionin e nxitur gjithandej BE-së dhe institucioneve të saj nga dinozaurët aziatikë.

Por, për fat të mirë dhe për më tepër për fatin e mirë dhe të rrallë të shqiptarëve, pas rënies së Bashkimit Sovjetik si Superfuqi, është vetëm një shtet në glob që ka qasje globale ndaj problemeve globale, e ajo është vetëm SHBA. Ndërkohë ishte pandemia COVID-19 ajo që përshpejtoi rënien e rritjes ekonomike kineze, dridhi ekonominë ruse si dhe tërë atë evropiane dhe ku më pas të gjithëve iu desh t'i ktheheshin vetvetes.

Kina për t'i tejkaluar problemet e brendshme, për t'i neutralizuar kundërshtarët e brendshëm politikë dhe për të parandaluar ndonjë krizë politike të mundshme, po projektonte nacionalizëm përbalë Tajvanit dhe mbështeste Korenë Veriore

kundër asaj Jugore, ndërkohë që Rusia po projektonte luftë kundër Ukrainës si dhe po e kaotizonte Evropën. Lojë kjo e njohur historikisht kur një shtet për shkak të telasheve të brendshme, fajtorin e projekton nga jashtë. Edhe BE veçse kishte filluar të shpërbëhej me Brexit në maje të gjithë kësaj.

Sigurisht që e tëra kjo po i sillte avantazhe veprimi SHBA-së, ekonomia e së cilës, meqë varej shumë më pak nga eksporti (vetëm 10% të GDP-së) sesa ekonomitë e lartpërmendura (p.sh. BE eksporton mbi 50% të GDP-së), e mori veten më shpejtë se gjithë konkurrentët globalë. Në këtë kuadër SHBA po tërhiqej përfundimisht nga Afganistani ku kishte parandaluar një aleancë të madhe të mundshme mes vendeve islame dhe Rusisë për t'iu kthyer menjëherë Evropës së dobët ushtarakisht dhe të përçarë politikisht, kjo e fundit veçse po rrëshqiste pothuajse tërësisht nën kontrollin e Moskës dhe pse jo të Pekinit. Nuk duhet harruar asnjëherë se një kombinim i trurit, kapitalit dhe teknologjisë evropiane me resurset e pafundme ruse do të mund të ndërtonte Superfuqinë e Euroazisë gjithnjë sipas kushteve ruse dhe kjo do ta sfidonte seriozisht supremacinë e SHBA-së si Superfuqia e vetme në glob. Prandaj, SHBA aktualisht është e përqendruar në Evropë ku edhe po kërkon me nguti mbylljen e problemeve që mund të rezultojnë me luftëra rajonale siç p.sh. është problemi Kosovë-Serbi, për t'iu kthyer më pas Azisë Lindore me Kinën në epiqendër të zhvillimeve atje. (vazhdon)







## Daku: Që nga dita e parë kuqezi

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Sulmuesi Mirlind Daku është ftuar në Kombëtaren e Shqipërisë për ndeshjet me Çekinë dhe Poloninë. Sulmuesi ka qenë më herët i ftuar në

Përfaqësuesen e Kosovës, ndërsa për herë të parë do të jetë pjesë e Shqipërisë. Daku i emocionuar për këtë ftesë, ka reaguar përmes një postimi në rrjetet sociale, ku ka

shpërndarë një fotografi në moshë të vogël teksa shihet veshur me një fanellë kuqezi me mbishkrimin: "Që nga dita e parë". Kështu ai nënkupton se që në fëmijëri është ndër

shqiptar dhe se gjithmonë ka dëshiruar të luajë për kombëtaren kuqezi. Shqipëria, përveç Dakut, për dy ndeshjet e muajit shtator e ka ftuar edhe Arbnor Mujën.



## Shqipëria publikon listën për ndeshjet e shtatorit

TIRANË, 1 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll është gati t'i nisë përgatitjet për dy ndeshjet e ardhshme të kualifikueseve të Kampionatit Evropian "Gjermani 2024" me trajnerin Sylvio Mendes Campos Junior që ka shpallur sot edhe me listën me emrat e 25 lojtarëve të ftuar për këto sfida. Krahasuar me ndeshjet e muajit qershor, këtë herë do të ketë ndryshime në listë, teksa ka emra të rinj, por edhe rikthime të rëndësishme në grupin kuqezi. Dy risitë kryesore janë emrat e sulmuesve Arbnor Muja dhe Mirlind Daku, të cilët ftohen për herë të parë me kuqezinjtë. Në mesfushë ka ndërkohë dy rikthime të rëndësishme me Klaus Gjasulën dhe Odise Roshin që janë ftuar për dy sfidat e shtatorit, ndërkohë që edhe në mbrojtje ka një tjetër emër që vjen pas një mungese, ai i Arlind Ajetit. Do të mungojë këtë herë mesfushori Armir Abrashi, teksa sa i përket pjesës tjetër të listës nuk ka ndryshime dhe konfirmohet grupi i lojtarëve, që ishte i impenjuar edhe në ndeshjet me Moldavinë dhe Ishujt Faroe në qershor.



### LISTA E FUTBOLLISTËVE

Etrit Berisha, Thomas Strakosha, Elhan Kastrati, Berat Gjimeshi, Arlind Ajeti, Ivan Balliu, Elseid Hysaj, Mario Mitaj, Enea Mihaj, Frederic Veseli, Odise Roshi, Ylber Ramadani, Nedis Bajrami, Kristjan Asllani, Keidi Bare, Qazim Laçi, Klaus Gjasula, Mirlind Daku, Arbnor Muja, Sokol Cikalleshi, Ernest Muçi, Myrto Uzuni, Jair Asani, Taulant Seferi.

Kombëtarja do të nisë zyrtarisht përgatitjet ditën e hënë, datë 4 shtator, me kuqezinjtë që do të grumbullohen në Tiranë dhe stërvitjet do të zhvillohen në Shtëpinë e Futbollit. Sakaq, në prag të grumbullimit trajneri Sylvinho do të dalë në konferencë për mediet ditën e

shtunë për të folur në lidhje me zgjedhjet e tij dhe objektivat për dy nga sfidat më të rëndësishme në këto kualifikuese. Shqipëria do të luajë në transfertë ndaj Republikës Çeke më 7 shtator dhe tri ditë më pas, më 10 shtator, do ta presë Poloninë në stadiumin "Air Albania".

## Mercedesi 'blindon' Hamiltonin dhe Russellin

Stuttgart, 1 shtator - Rinovimi i shumëpritur i kontratës ka ardhur. Lewis Hamiltoni, shtatë herë kampion bote në Formula 1, do ta pilotojë makinën e Mercedesit deri në vitin 2025. E njëjta situatë edhe me shokun e tij të skuadrës George Russell që, gjithashtu, ka rinovuar me Mercedesin deri në vitin 2025. Pra, makina gjermane do t'u besojë sërish dy pilotëve britanike edhe për dy sezone të tjera. Lajmi u zyrtarizua nga Mercedesi, që konfirmoi se kishte arritur marrëveshjen me të dy pilotët e saj. "Çdo ditë ëndërrim më të jem më të mirët dhe kemi muaj që i dedikohemi këtij objekti", ka thënë Hamiltoni. "Të shkosh në majë nuk vjen sa hap e mbyll sytë, duhet shumë punë, dedikim. Për mua është një nder të hyj në librat e historisë me Mercedesin. Kemi



mësuar si nga sukseset ashtu dhe dështimet, ndaj do të vazhdojmë t'i ndjekim ëndrrat tona. Historia jonë nuk ka përfunduar ende", u shpreh Hamiltoni. "E di që titulli i tetë kampion mund të vijë një ditë, por nuk garoj në pistë për t'u

hakmarrë ndaj Max Verstappenit, për atë që ndodhi në vitin 2021. Mendoj se me këtë skuadër mund ta fitoj edhe një titull tjetër dhe nuk do të ndalemi derisa t'ia dalim mbanë së bashku", ka shtruar britaniku Hamiltoni.

### SHKURT

#### Jalen Nesbitt përforcon KB Ylli

KB Golden Eagle Ylli e ka zyrtarizuar përforcimin e radhës. Skuadra nga Suhareka ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me basketbollistin Jalen Nesbitt. Edicionin e fundit ai ishte pjesë e ekipit Amics Castello në kategorinë e dytë të Spanjës dhe pati një mesatare prej 8 pikëve, 5 kërcimeve e 2 asistimeve për ndeshje. Nesbitt në Spanjë ka luajtur edhe tek ekipi Almansa, ndërsa karrierë në Evropë ka bërë edhe në Danimarkë e Sllovaki. Ai është ameriçani i parë dhe i huaji i dytë pas Henrik Shirkos që është zyrtarizuar për edicionin e ri.

#### Union Berlini zyrtarizon transferimin e Bonuccit

Skuadra e Union Berlinit ka zyrtarizuar transferimin e mbrojtësit Leonardo Bonucci nga Juventus. Klubi gjerman në këtë afat kalimtar e ka transferuar Robin Gosens nga Interi, kurse të premten zyrtarizoi me parametra zero mbrojtësin legjendar të "Zonjës së Vjetër". "FC Union Berlin ka nënshkruar me kampionin në fuqi të Evropës, Leonardo Bonucci. 36-vjeçari ndryshon ambient nga kampionët rekord italianë, Juventus, Torino, në Alte Försterei", thuhet në njoftimin e Union Berlinit.

#### Brightoni zyrtarizon transferimin e Ansu Fatit

Brighton & Hove Albion ka njoftuar zyrtarisht transferimin e sulmuesit Ansu Fati nga Barcelona. "Kemi kënaqësinë të konfirmojmë nënshkrimin e Ansu Fatit në huazim për një sezon nga Barcelona", thuhet në njoftimin e Brightonit. Në anën tjetër, Barcelona ka njoftuar se huazimi është i thjeshtë dhe pa të drejtë blerje nga klubi anglez. "FC Barcelona dhe Brighton & Hove Albion Football Club kanë arritur marrëveshje për huazimin e lojtarit Ansu Fati deri më 30 qershor 2024. Nuk ka asnjë mundësi për një transferim të përhershëm", thuhet në njoftimin e Barcelonës.

#### Chelsea transferon Palmerin nga City

Chelsea ka njoftuar zyrtarisht transferimin e sulmuesit të talentuar, Cole Palmer nga Manchester City. Ekipi nga "Stamford Brige" ka nënshkruar me talentin Cole Palmer nga City në një transferim që thuhet se ka kushtuar rreth 50 milionë euro. Është vetë Chelsea që ka konfirmuar transferimin e tij me anë të faqeve zyrtare duke thënë se lojtari ka nënshkruar kontratë shtatëvjeçare me opsion vazhdimi. "Chelsea ka kënaqësinë të njoftojë nënshkrimin e reprezentuesit anglez U-21, Cole Palmer nga Manchester City. Palmer ka nënshkruar një kontratë shtatëvjeçare me një opsion klubi për një vit tjetër dhe do të bashkohet me skuadrën e Mauricio Pochettinos përpara ndeshjes sonë me Nottingham Forestin në Premierë Ligë", thuhet në njoftimin e klubit anglez.

## Ofertë nga Arabia Saudite edhe për Lewandowskin

Barcelona ka marrë një ofertë nga një klub saudit për Robert Lewandowskin. Oferta e Arabisë Saudite është rreth 40 milionë euro dhe ka mbërritur në ditën e

fundit të merkatos për futbollin spanjoll dhe evropian, por jo për Arabinë Saudite, e cila mbetet e hapur deri më 20 shtator. Ndaj, operacioni i largimit të futbollistit

mund të bëhet deri në mbylljen e merkatos saudite, por Barcelona nuk ka mundur të inkorporojë askënd në vend të tij. Lewandowski aktualisht është

35-vjeçar dhe u ble verën e kaluar për 45 milionë euro, plus 5 milionë bonuse nga Bayern Muncheni. Ky sezon ka nisur me një gol për polakun në tri


ndeshjet e para të La Ligas, ndërsa sezonin e kaluar shënoi 23 gola në 34 ndeshje në kampionatin spanjoll, ose 33 gola në 46 ndeshje në të gjitha garat.



## NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Ligji Nr. 06/L -016, konform nenit 112 paragrafi 1,2,3,4 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar Una Projekt 23 Sh.p.k. me numër unik identifikues (NUI) : 812017441 me seli Rruga Shaip Kamberi, Nr. 90 Komuna Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin dhe ka caktuar likuidatorin Shqipe Gashi me ID: 2009756127 me vendbanim në me adresë: Rr. Shaip Kamberi, Nr. 90 Komuna: Prishtinë me tel: 044/636-437 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të porealizuara dhe raporte Kreditore-Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpejite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Meleq Novosella shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "28 Nëntori" Prishtinë, viti 76/77.

- Besart Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.

- Loni Caffè SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 811288994.

- Kreshnik Kurti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "TREPÇA".

- Auto Bajra-Bajram E.Tahiri B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 811581463.

- SALIH AHMETI, Shpall te pavleshme deftesat 10,11,12 DHE DIPLOMEN E SHMLT "ARKITEKT SINANI"

- SARA KABASHI, Shpall te pavleshme deftesen e shkolles fillore ;NONDA BULKA"

- Yll Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "NexhmedinNixha".

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "NexhmedinNixha".

- Luisna Karaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.t. "Kadri Kusari".

- OsmonSeferi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "FehmiLladrovci" Drenas.

- Luisna Karaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m.t. "Kadri Kusari".

- Tehnoburimi D.D SH.A shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810548307.

- Ibrahim Bajrami shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".



